

Të Hyrat dhe Shpenzimet buxhetore, Janar Qershor 2026

Bazuar në të dhënat e publikuara nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT), gjatë periudhës Janar - Qershor 2026, të hyrat buxhetore kanë arritur në 1,682.8 milionë euro, duke shënuar rritje prej 6.8% krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2025. Në strukturën e të hyrave (në %), Të hyrat tatimore përbëjnë pjesën më të madhe me 90.4% (ose 1,521.0 mln €).

Në anën e shpenzimeve, Shpenzimet buxhetore në gjashtëmujorin e parë të vitit 2026 arrijnë në 1,758.5 milionë euro, që paraqet një rritje prej 21.8% krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2025, kjo paraqet rritje më të lartë krahasuar me periudhat e njeta te viteve prapake. Rritja mbështetet kryesisht nga shpenzimet rrjedhëse Paga dhe shtesa me rritje prej 23.1% dhe Subvencione dhe transfere rritje prej 40.6%, të cilat marrin pjesë me rreth 31% (paga dhe shtesa), respektivisht me rreth 41% (subvencione dhe transfere), në totalin e shpenzimeve buxhetore.

Nga tabela vijuese pasqyrohen trendet e te hyrave dhe shpenzimeve buxhetore periudhës Janar - Qershor 2022-2026, Ndryshimin 2026/2025 dhe Progresi-Realizimin në përqindje për vitin aktual krahasuar me Buxhetin 2026 në (SIMFK).

Tabela 1. Të Hyra buxhetore dhe Shpenzime buxhetore për Janar - Qershor 2022-2026

Përshkrimi (në milion Euro)	I-VI/2022	I-VI/2023	I-VI/2024	I-VI/2025	I-VI/2026	Ndryshimin 2026/2025	Realizimi / Buxheti 2026
1.1 Të HYRAT BUXHETORE	1,135.7	1,352.1	1,432.9	1,575.4	1,682.8	6.8%	46.1%
1.1.1 Të hyrat tatimore	1,012.3	1,155.4	1,275.8	1,408.1	1,521.0	8.0%	46.7%
Tatimet Direkte	215.5	261.0	270.8	291.3	331.0	13.6%	50.7%
Tatimet Indirekte	832.7	921.1	1,034.3	1,152.5	1,224.8	6.3%	45.2%
Kthimet Tatimore	-35.9	-26.8	-29.3	-35.8	-34.8	-2.7%	33.8%
1.1.2 Të hyrat jo-tatimore	117.9	119.9	153.9	163.0	157.3	-3.5%	42.6%
1.1.3 Mbështetje buxhetore dhe grantet	0.0	67.5	0.0	0.0	0.0		0.1%
1.2 Pranimet nga GPD	5.5	9.3	3.2	4.4	4.5	2.5%	37.5%
2.1 SHPENZIMET BUXHETORE	977.0	1,136.2	1,242.0	1,443.3	1,758.5	21.8%	44.1%
2.1.1 Shpenzimet rrjedhëse	878.0	958.8	1,014.3	1,169.5	1,499.7	28.2%	51.5%
Paga dhe shtesa	328.7	372.0	442.7	440.7	542.5	23.1%	55.3%
Mallra dhe shërbime	129.3	144.4	160.9	201.0	218.3	8.6%	40.9%
Shpenzime komunale	13.0	12.8	13.4	16.2	19.6	21.0%	53.5%
Subvencione dhe transfere	407.0	429.5	397.4	511.6	719.3	40.6%	53.2%
2.1.2 Shpenzimet kapitale	79.3	150.7	196.6	243.2	226.9	-6.7%	22.2%
2.1.3 Shpenz. e Interesit për borxh publik	16.9	22.8	21.2	26.1	26.1	0.3%	52.8%
2.2 Pagesat nga GPD	2.8	3.9	9.9	4.6	5.8	26.7%	44.7%


Burimi: Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT),
 Raporti Gjashtëmujor 2026 <https://mf.rks-gov.net/Thesari/Page/33>

Shpenzimet buxhetore gjatë kësaj periudhe shënuan vlerën prej 1,758.5 milionë euro, duke arritur kështu normën e ekzekutimit në 44.1% krahasuar me vlerën totale vjetore të buxhetuar (Buxheti 2026 në SIMFK në vlerë prej 3,984.3 milionë euro) për këtë kategori.

Nëse analizojmë sipas strukturës së shpenzimeve për periudhën Janar-Qershor 2026 (në %), peshën kryesore e mbajnë shpenzimet rrjedhëse:

- ✓ Subvencione dhe transfere, përbëjnë pjesën më të madhe me 40.9% (ose 719.3 mln €), duke shënuar edhe rritjen më të madhe vjetore prej 40.6%,
- ✓ Paga dhe shtesa, renditen të dytat me 30.9% të buxhetit total (ose 542.5 mln €),
- ✓ Shpenzimet kapitale, përbëjnë vetëm 12.9% të gjithsej shpenzimeve në gjashtëmujorin e parë 2026, ndërsa
- ✓ Mallra dhe shërbime, përfshijnë 12.4% të buxhetit dhe Të tjera si Shpenzimet e interesit për borxh publik (1.5%) dhe shpenzimet komunale (1.1%).

Figura 1. Shpenzimet buxhetore, Buxhetin 2026 në (SIMFK), Realizimin Janar - Qershor 2026 në milionë euro, Progresin e ekzekutimit në përqindje për kategori të shpenzimeve.




Burimi: Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT), Raporti Gjashtëmujor 2026 <https://mf.rks-gov.net/Thesari/Page/33>

(*) të shtylla Shpenzimet rrjedhëse përfshirë edhe 10.6 milionë euro, nga zëri Rezerva.

Nga Figura 1 vërehet një shpërndarje e pabarabartë e performancës së ekzekutimit të shpenzimeve. Derisa kategoritë e shpenzimeve operative dhe administrative si Paga dhe shtesa (55.3%) dhe Shpenzimet komunale (53.5%) shfaqin shkallë të lartë të ekzekutimit në gjysmën e parë të vitit, realizimi i Shpenzimeve kapitale me vetëm 22.2% tregon një ngadalësim të theksuar në fillimin

dhe zbatimin e projekteve të reja zhvillimore, gjë që kërkon vëmendje të shtuar dhe përshejtim të procedurave gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit.

Figura 2. Shpenzimet Kapitale Janar-Qershor sipas viteve 2022-2026 në milionë euro dhe rritje në % (v-m-v).




Burimi: Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT),

Nga Figura 2 vërehet ndryshime ku shpenzimet kapitale shënuan një rritje të konsiderueshme dhe të qëndrueshme vjetore gjatë periudhës 2022-2025 (duke u rritur nga 79.3 milionë euro në 243.2 milionë euro), gjashtëmujori i parë i vitit 2026 shënon rënien e parë vjetore prej -6.7% (duke rënë në 226.9 milionë euro). Kjo prirje negative pasqyron një ngadalësim të ritmit të investimeve publike, duke rrezikuar potencialisht stimulin ekonomik afatgjatë që vjen nga projektet e infrastrukturës dhe zhvillimit.

Ndryshimet në shpenzimet kapitale ndikojnë drejtpërdrejt në zhvillimin ekonomik dhe në rritjen BPV-së. Kur shpenzimet kapitale rriten, zakonisht rriten edhe investimet publike, në energji, në infrastrukturë, arsim dhe projekte zhvillimore. Këto investime përmirësojnë produktivitetin e ekonomisë, krijojnë vende pune dhe stimulojnë aktivitetin ekonomik, duke ndikuar pozitivisht në rritjen e përgjithshme ekonomike. Në periudhat kur shpenzimet kapitale kanë vlera më të ulëta, në parim investimet publike zvogëlohen dhe kjo mund të ngadalësojë zhvillimin ekonomik, pasi realizohen më pak projekte infrastrukturore dhe investime afatgjata.

Figura 3. Shpenzimet sipas kategorive në % në raport me Gjithsej shpenzimet periudhën Janar-Qershor 2022-2026.



Burimi: Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT)

Nëse analizojmë trendet në Figurat 3, për periudhën Janar-Qershor 2022-2026 vërehet një ndryshim i dukshëm i strukturës së shpenzimeve buxhetore.

Ky ndryshim strukturor i shpenzimeve vë në dukje një rrezik të lartë të transferimit të resurseve buxhetore nga investimet produktive drejt skemave konsumi. Subvencionet dhe transferet kanë rikthyer dominancën e tyre duke zënë 40.9% të totalit të shpenzimeve në vitin 2026 (një rritje e ndjeshme nga 35.4% sa ishin në vitin 2025), kjo rritje vjen drejtpërdrejt në dëm të Shpenzimeve kapitale, pesha e të cilave ka rënë në vetëm 12.9%.

Nga perspektiva e politikave makroekonomike, kjo zhvendosje mund të nxisë konsumin afatshkurtër, por redukton aftësinë e vendit për të ndërtuar kapacitete të qëndrueshme prodhuese dhe rrit rrezikun e presioneve inflacioniste.